



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 02.03.2022)*

**Pika 1 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të 2 (dy) anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor: z. {...} dhe z. {...}.

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 11:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Illir Rusi*** (anëtar)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

***1. Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.***

***Mbledhje e Këshillit të Lartë Gjyqësor  
Tiranë, më 02.03.2022 (Pika 1)***

2. {...}, ish-anëtar i KLGJ-së.
3. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
6. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit & Administrimit të Buxhetit.*
7. *Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
8. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Valbona Bala, Përfaqësuese e USAID-it.*
10. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

## **RENDI I DITËS:**

1. Shqyrtimi i projektvendimit për deklarimin e mbarimit të mandatit të 2 (dy) anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor: z. {...} dhe z. {...}.

(Çelet mbledhja plenare me falënderimet e Kryetares së Këshillit të Lartë Gjyqësor drejtuar anëtarëve që u ka mbaruar mandati, z. {...} dhe z. {...}, e më pas i urohet mirëseardhja anëtarëve të rinj të cilët i bashkohen Këshillit, z. Ilir Rusi dhe znj. Yllka Rupa.)

*Naureda Llagami:* Fillojmë pa humbur kohë me rendin e ditës.

Çështja e parë ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimeve për deklarimin e mbarimit të mandatit të dy anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...} dhe z. {...}.

Siç jeni në dijeni, Kushtetuta na detyron që në mbarimin e mandateve dhe me plotësimin e tyre me kolegët pasardhës, nga ana e Këshillit të bëhet deklarimi i përfundimit të mandatit.

Dy kolegët janë zgjedhur me vendim të Kuvendit nr. 22, i cili është botuar në Fletoren Zyrtare më datë 28 shkurt 2022. Konkretisht, sipas vendimit të Kuvendit, është

parashikuar që: “I. Konsiderohen të zgjedhur kandidatët e listës së tretë për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor që ka rezultuar nga hedhja e shortit në Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë nga trupa e pedagogëve të Fakulteteve të Drejtësisë dhe të Shkollës së Magjistraturës për shkak të mosarritjes së shumicës prej dy të tretave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit si më poshtë: 1. Yllka Rupa dhe 2. Ilir Rusi. II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.” – (Fletore Zyrtare nr.32, datë 28.02.2022)

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, nga ana e Këshillit është e nevojshme që të miratohen projekt-aktet për deklarimin e mbarimit të mandatit të z. {...} dhe më tej të z. {...}.

Kështu, unë do ftoja kolegët të miratonim projekt-aktin e parë që ka të bëjë me deklarimin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}. Jemi dakord?

**Ilir Rusi:** Dakord.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}.

2. Përfundimi i qëndrimit në detyrë të z. {...} më datë 24.02.2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë tek projekt-akti tjetër që ka të bëjë me deklarin e mbarimit të mandatit dhe përfundimin e qëndrimit në detyrë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}.  
Jemi dakord?

*Ilir Rusi*: Pro.

*Irena Plaku*: Dakord.

*Dritan Hallunaj*: Pro.

*Ridvan Hado*: Dakord.

*Alban Toro*: Dakord.

*Fatmira Luli*: Dakord.

*Marçela Shehu*: Dakord.

*Yllka Rupa*: Dakord.

*Brikena Ukperaj*: Pro.

*Klodian Kurushi*: Dakord.

*Naureda Llagami*: Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Deklarimin e mbarimit të mandatit të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, z. {...}.

2. Përfundimi i qëndrimit në detyrë të z. {...} më datë 24.02.2022.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë me botimin e tij në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 1 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 02.03.2022)*

***Pika 2 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar me vendimin nr. 601, 23.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.<sup>1</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 11:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

- 1. Naureda Llagami (kryetare)***
- 2. Klodian Kurushi (anëtar)***
- 3. Fatmira Luli (anëtare)***
- 4. Irena Plaku (anëtare)***
- 5. Dritan Hallunaj (anëtar)***
- 6. Ridvan Hado (anëtar)***
- 7. Alban Toro (anëtar)***
- 8. Brikena Ukperaj (anëtare)***
- 9. Marçela Shehu (anëtare)***
- 10. Ilir Rusi (anëtar)***

<sup>1</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e treta.

11. *Yllka Rupa*

(anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. {...}, *ish-anëtar i KLGJ-së.*
3. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
6. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit & Administrimit të Buxhetit.*
7. *Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
8. *Lorena Gerverni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Valbona Bala, Përfaqësuese e USAID-it.*
10. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

2. Shqyrtimi i projektvendimit “Për një ndryshim në vendimin nr.13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, i ndryshuar me vendimin nr. 601, 23.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Naureda Llagami:* Në vijim kemi projektvendimin e dytë i cili ka të bëjë me ndryshimin e vendimit “Mbi ngritjen dhe përbërjen e komisioneve të përhershme”, të ndryshuar me vendimin nr. 601, datë 23.12.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Në traditën që kemi pasur lidhur me ndarjen e komisioneve me anëtarët e rinj, pasi i kërkuam mendim dhe pasi u dakordësuan të dy anëtarët e rinj për preferencat që kishin lidhur me kontributin që donin të jepnin në komisionet përkatëse, arritëm në përfundimin dhe prandaj propozojmë dhe projekt-aktin që, zonja Yllka Rupa do të jetë

anëtare në Komisionin e Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale dhe zoti Ilir Rusi do të jetë anëtar në Komisionin e Disiplinës. Vendimi është ndryshuar duke i përcaktuar jo vetëm si anëtarë të përhershëm në këto komisione, por edhe zëvendësues aty ku kanë qenë më përpara z. {...} dhe z. {...}.

Jeni dakord me projekt-aktin?

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Dakord.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

Vendimi nr. 13, datë 18.01.2019 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Mbi ngritjen dhe përbërjen e Komisioneve të Përhershme”, i ndryshuar me vendimin nr. 601, datë 23.12.2021, ndryshon si më poshtë:

1. Në pikën 1:

Për Komisionin e Planifikimit Strategjik Administrimit dhe Buxhetit (KPSAB)

Si anëtare zëvendësuese:

1. Në vend të z. {...} zgjidhet znj. Yllka Rupa.

Për Komisionin Disiplinor (KD)

Në vend të z. {...} zgjidhet z. Ilir Rusi.

Për Komisionin e Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale (KVEVP)

Në vend të z. {...} zgjidhet znj. Yllka Rupa.

Për Komisionin e Zhvillimit të Karrierës (KZHK)

Si anëtar zëvendësues:

Në vend të z. {...} zgjidhet z. Ilir Rusi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

\* \* \*

(Pika 2 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 02.03.2022)*

***Pika 3 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).<sup>2</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 11:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Illir Rusi*** (anëtar)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

<sup>2</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e katërta.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Erjon Muharremaj, ish-anëtar i KLGJ-së.*
3. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
6. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit & Administrimit të Buxhetit.*
7. *Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
8. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Valbona Bala, Përfaqësuese e USAID-it.*
10. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

3. Shqyrtimi i projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relatore znj. Marçela Shehu).

*Naureda Llagami:* Kalojmë sipas rendit të ditës në një nga çështjet mjaft të rëndësishme, që ka të bëjë me shqyrtimin e projektvendimit “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të z. {...}”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës dhe do të relatohet nga zonja Marçela Shehu.

*Marçela Shehu:* Faleminderit, Kryetare!

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pas plotësimit të kuadrit ligjor nëpërmjet miratimit të akteve nënligjore të autorizuar nga ligji, në ushtrim të përgjegjësisë për mbarëvajtjen e sistemit gjyqësor dhe në veçanti të funksionit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve të të

gjitha niveleve, në kuadër të plotësimit të pozicioneve të lira në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, ndër të tjera, ka hapur procedurat e ngritjes në detyrë edhe për katër pozicione të lira në fushën e të drejtës administrative, respektivisht me vendimet nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2021.

Në procedurat e ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, brenda afateve respektive të kandidimit, kandiduan gjithsej dhjetë kandidatë dhe konkretisht: znj. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}; z. {...}; znj. {...}; znj. {...}; znj. {...}; z. {...} dhe z. {...}. Nga këta kandidatë, shtatë prej tyre kandiduan për dy nga pozicionet e lira, dy kandidatë të tjerë për një nga pozicionet e lira dhe një kandidat për tre pozicione të lira (konkretisht sipas tabelës që ju keni përpara në relacionin e përgatitur nga Komisioni).

Sipas pikës 9, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në një procedurë ngritjeje në detyrë për një pozicion të lirë, Këshilli i Lartë Gjyqësor bën renditjen e kandidatëve që përmbushin kriteret, renditje kjo që bëhet në funksion të përzgjedhjes së kandidatit të renditur më lart, i cili do të duhet të ngrihet në detyrë në atë pozicion të lirë ose të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë.

Për të evidentuar kandidatët që përmbushnin kriteret e kandidimit, të emërimit në Gjykatën e Lartë, Këshilli realizoi procedurat e verifikimit të plotësimit nga secili kandidat të kriterëve të më poshtme:

- 1) “përvojës profesionale minimale”;
- 2) “mospasjes masë disiplinore në fuqi”;
- 3) “mosqenies në situatën e papajtueshmërisë ambientale”;
- 4) “verifikimi i pasurisë dhe figurës”.

Për të dhjetë kandidatët, Këshilli i Lartë Gjyqësor verifikoi plotësimin nga ata të të gjitha kriterëve të kandidimit, duke vendosur kualifikimin e tyre dhe vijimin e procedurave përkatëse për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë, për pozicionet e lira respektive ku ata kanë kandiduar. Konkretisht Këshilli ka vendosur kualifikimin për të gjithë kandidatët, pra për z. {...}, z. {...}, z. {...}, z. {...}, znj. {...}, znj. {...}, znj. {...}, z. {...}, znj. {...} dhe z. {...}.

Vlen të theksojmë që zoti {...}, në vijim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë është tërhequr nga kandidimi për të dyja pozicionet dhe Këshilli me vendimet e tij nr. 318, datë 22.07.2021 dhe nr. 19, datë 17.01.2022 ka vendosur për përfundimin e të dyja procedurave të ngritjes në detyrë.

Krahas procedurave të verifikimit të kritereve të kandidimit, paralelisht, për kandidatët kanë vijuar edhe procedurat e vlerësimit etik dhe profesional, konkretisht:

- 1) vlerësimi me qëllim gradimi, për periudhën e vlerësimit 2013-2016;
- 2) vlerësimi i përshpejtuar për vitin 2019.

Ndërsa proceset e verifikimit të kritereve të kandidimit dhe atyre të vlerësimit etik dhe profesional të kandidatëve vijonin, për përfundimin në kohë të procedurave tërësore të ngritjes në detyrë, propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin nr. 55, datë 16.02.2021, filloi procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve, ndër të tjera, edhe të kandidatëve nga radhët e gjyqtarëve, për katër pozicionet e lira në fushën e të drejtës administrative, të shpallura me vendimet e Këshillit nr. 82, nr. 83, nr. 84, datë 26.02.2020 dhe nr. 245, datë 09.07.2020.

Sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 245, datë 09.07.2020, kjo procedurë është përmbyllur dhe Këshilli, ndërsa ka miratuar renditjen e kandidatëve, me vendimin nr. 322, datë 22.07.2021, ka vendosur që z. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Me Dekretin nr. {...}, datë 29.07.2021, Presidenti i Republikës së Shqipërisë ka emëruar z. {...} gjyqtar të Gjykatës së Lartë.

Sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 84, datë 26.02.2020, kjo procedurë është përmbyllur dhe Këshilli, ndërsa ka miratuar renditjen e kandidatëve, me vendimin nr. 57, datë 10.02.2022, ka vendosur që znj. {...} të propozohet për emërim në Gjykatën e Lartë për këtë pozicion të lirë. Edhe zonja {...} tashmë është dekretuar nga Presidenti i Republikës dhe është emëruar gjyqtare e Gjykatës së Lartë.

Sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020, kjo procedurë kishte pesë kandidatë: 1) Znj. {...}, 2) Z. {...}, 3) {...}, 4) Znj. {...} dhe 5) Z. {...}.

Zoti {...}, në vijim të procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën e Lartë është tërhequr nga kandidimi për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020 dhe Këshilli me vendimin e tij nr. 318, datë 22.07.2021 ka vendosur për përfundimin e kësaj procedure të ngritjes në detyrë.

Gjithashtu është administruar tërësisht dokumentacioni i nevojshëm në funksion të përmblyljes së procedurës së përzgjedhjes sa i përket procedurës së ngritjes në detyrë për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative të shpallur me Vendimin e Këshillit nr. 83, datë 26.02.2020.

Kështu, janë administruar për zotin {...} dy vlerësimet etike dhe profesionale; për zotin {...} dy vlerësimet etike dhe profesionale; dhe për kandidatet zonja {...} dhe znj. {...} dy vlerësimet etike dhe profesionale.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit të administruar, në përputhje me Kreun IV (Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve), të Vendimit nr.70/2020, relatorja realizoi renditjen e kandidatëve për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur nga Këshilli me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, për ngritjen në detyrë/emërimin në Gjykatën e Lartë.

Mbështetur në nenet 136, 147 dhe 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenet 85, 86, 97 dhe 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikat 9, 12 dhe 14, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në vendimin e tij nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, Këshilli i Lartë Gjyqësor, me vendimin paraprak të propozimit për emërim nr. 61, datë 15.02.2022, vendosi:

1. Miratimin e renditjes së gjyqtarëve që kandidojnë për t’u emëruar në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

- 1) Z. {...};
- 2) Znj. {...};
- 3) Znj. {...}; Z. {...}.

2. Propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 83, datë 26.02.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, të kandidatit z. {...}.

Ky vendim, iu njoftua rregullisht, më datë 15.02.2022, kandidatëve z. {...}, znj. {...}, znj. {...} dhe z. {...}, të cilët, bazuar në pikën 12, të nenit 48, të Ligjit për Statusin, gëzonin të drejtën e ankimit ndaj këtij vendimi.

Kandidatët, znj. {...} dhe z. {...}, kanë ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të mësipërm, duke paraqitur padi pranë Gjykatës Administrative të Apelit.

Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidatja znj. {...}, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. {...}, datë 01.03.2022, ka vendosur: Rrëzimin e padisë.

Pas shqyrtimit të padisë së paraqitur nga kandidati nga z. {...}, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë me vendimin nr. {...}, datë 01.03.2022, ka vendosur: Rrëzimin e padisë.

Më datë 01.03.2022 u kërkua informacion nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë lidhur me faktin nëse kandidatët e tjetër, z. {...} dhe znj. {...} kishin ushtruar ankim apo jo ndaj vendimit paraprak të propozimit për emërim nr. 61, datë 15.02.2022, të Këshillit. Ndërkohë nga kjo gjykatë u konfirmua që dy kandidatët nuk kanë paraqitur ankim.

Në kushtet si më lart, vendimi paraprak i propozimit për emërim nr. 61, datë 15.02.2022, ka marrë formë të prerë më datë 01.03.2022.

Për rrjedhojë, në zbatim të pikës 70, të vendimit të Këshillit nr. 70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, është përgatitur dhe projektvendimi përkatës për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatit z. {...}.

Projektvendimi është i strukturuar në 2 pika.

Pika 1 e projektvendimit përmban propozimin për Presidentin e Republikës, të emërimit në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.

Në pikën 2 të projektvendimit përcaktohet se një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky është relacioni që shoqëron edhe projektvendimin e paraqitur sot për shqyrtim dhe miratim mbledhjes plenare “Për propozimin për emërim në Gjykatën e Lartë, të kandidatit z. {...}

**Naureda Llagami:** Shumë faleminderit Marçela për relatimin!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë koment ose sugjerim, në votimin e projekt-aktit.

**Ilir Rusi:** Pro.

**Irena Plaku:** Dakord.

**Dritan Hallunaj:** Pro.

**Ridvan Hado:** Dakord.

**Alban Toro:** Dakord.

**Fatmira Luli:** Dakord.

**Marçela Shehu:** Dakord.

**Yllka Rupa:** Pro.

**Brikena Ukperaj:** Pro.

**Klodian Kurushi:** Dakord.

**Naureda Llagami:** Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit z. {...}.

2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 3 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

***PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR***

*(Mbajtur, më 02.03.2022)*

***Pika 4 e rendit të ditës me objekt:*** Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).<sup>3</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 11:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)

<sup>3</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e pesta.



10. *Ilir Rusi* (anëtar)  
11. *Yllka Rupa* (anëtare)

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Erjon Muharremaj, ish-anëtar i KLGJ-së.*
3. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
6. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit & Administrimit të Buxhetit.*
7. *Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
8. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Valbona Bala, Përfaqësuese e USAID-it.*
10. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

4. Shqyrtimi i projektvendimit “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).

*Naureda Llagami:* Kalojmë në projekt-aktin e radhës që ka të bëjë me përsëritjen e komandimit të gjyqtarës znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Për më shumë detaje, fjalën ia jap kryetarit të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës, z. Kurushi.

***Klodian Kurushi:*** Faleminderit, Kryetare!

Të nderuar kolegë!

Komisioni sot, së bashku me projektvendimin për përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor ka bashkëngjitur edhe relacionin përkatës të cilin unë po e parashtroj në mënyrë të shkurtuar, për sa kohë besoj që të gjithë anëtarët janë njohur me përmbajtjen e tij.

Në këtë relacion i është propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor që zonjës {...} t’i përsëritet komandimi pasi plotëson të gjitha kriteret ligjore të parashikuara në ligjin “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin nr. 104, datë 05.07.2019 për komandimin e gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor. Kështu që ne kemi menduar që zonja {...} i plotëson të gjitha kushtet dhe për të miratuar edhe një herë kërkesën e paraqitur prej saj për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, dhe për këtë arsye kemi parashtruar sot edhe relacionin përkatës.

Bashkëlidhur relacionit është edhe projektvendimi i cili përmban gjithsej 3 pika.

Në pikën e parë të tij është përsëritja e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dyvjeçar (sipas kërkesës së përsëritur nga ana e saj).

Efektet juridike të vendimit propozojmë që të fillojnë më datë 02.03.2022.

Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Dibër (*lapsus në projektvendim, pasi bëhet fjalë për Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë*).

Ky vendim propozojmë që të hyjë në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Faleminderit!

***Naureda Llagami:*** Faleminderit, zoti Kurushi!

Ftoj kolegët, nëse nuk kanë ndonjë koment apo sugjerim, në votimin e projekt-aktit sipas propozimit të ardhur nga Komisioni.

*Ilir Rusi:* Pro.

*Irena Plaku:* Dakord.

*Dritan Hallunaj:* Pro.

*Ridvan Hado:* Dakord.

*Alban Toro:* Dakord.

*Fatmira Luli:* Dakord.

*Marçela Shehu:* Dakord.

*Yllka Rupa:* Pro.

*Brikena Ukperaj:* Pro.

*Klodian Kurushi:* Dakord.

*Naureda Llagami:* Dakord.

Atëherë, Këshilli vendosi:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e “nëpunësit përgjegjës për vlerësimin” në Njësinë e Vlerësimit Profesional dhe Etik të Gjyqtarëve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat dyvjeçar.

2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 02.03.2022.

3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe gjykatës së rrethit gjyqësor përkatës (Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë).

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

\* \* \*

(Pika 4 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2022

**PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*(Mbajtur, më 02.03.2022)*

**Pika 5 e rendit të ditës me objekt:** Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_\_ Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.<sup>4</sup>

***Drejton mbledhjen Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, zonja Naureda Llagami.***

***Mbledhja u zhvillua në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 10:45 dhe mbaroi në orën 11:15.***

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Naureda Llagami*** (kryetare)
2. ***Klodian Kurushi*** (anëtar)
3. ***Fatmira Luli*** (anëtare)
4. ***Irena Plaku*** (anëtare)
5. ***Dritan Hallunaj*** (anëtar)
6. ***Ridvan Hado*** (anëtar)
7. ***Alban Toro*** (anëtar)
8. ***Brikena Ukperaj*** (anëtare)
9. ***Marçela Shehu*** (anëtare)
10. ***Illir Rusi*** (anëtar)
11. ***Yllka Rupa*** (anëtare)

<sup>4</sup> Sipas rendit të ditës kjo çështje ishte parashikuar të trajtohej e dyta.

Merrnin pjesë gjithashtu:

1. *Rudin Baqli, Sekretar i Përgjithshëm pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.*
2. *Erjon Muharremaj, ish-anëtar i KLGJ-së.*
3. *Maela Alicanaj, Drejtore e Departamentit të shërbimeve juridike dhe marrëdhënieve me jashtë.*
4. *Luljeta Laze, Drejtore e Departamentit të Programimit dhe Administrimit të Buxhetit.*
5. *Kelment Greca, Drejtor i Departamentit të Administrimit të Gjykatave dhe Teknologjisë së Informacionit.*
6. *Xhevdet Haxhiu, Drejtor pranë Drejtorisë së Programimit & Administrimit të Buxhetit.*
7. *Etrita Petriti, Drejtore e Drejtorisë së Burimeve Njerëzore.*
8. *Lorena Gerveni, Drejtore e Drejtorisë së Marrëdhënieve me Publikun, me Jashtë dhe Botimet.*
9. *Valbona Bala, Përfaqësuese e USAID-it.*
10. *Staf administrativ i KLGJ-së.*

#### **RENDI I DITËS:**

5. Shqyrtimi i projektvendimit “Për zgjedhjen e z./znj. \_\_\_\_ Zëvendëskryetar të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

*Naureda Llagami:* Kalojmë në pikën tjetër të rendit të ditës.

Siç jeni në dijeni, ligji na detyron që në mbledhjen e parë të zgjidhet Zëvendëskryetari (neni 59, pika 1 e ligjit “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Gjithashtu ne kemi miratuar si Këshill, në mbledhjen e parë, disa rregulla për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit dhe Kryetarit, në rastin konkret janë të njëjtat rregulla si për Kryetarin dhe për Zëvendëskryetarin, rregulla që jua kam parashtruar që të gjithëve. Votimi është i hapur dhe duhet të kemi një shprehje të interesit nga anëtarët jogjyqtarë për sa i përket zgjedhjes së Zëvendëskryetarit, dhe më pas të kalojmë në procedurën e

votimit të hapur e cila do jetë me shkrim. Nga ana e administratës janë bërë gati i gjithë dokumentacioni.

Zyrtarisht është paraqitur vetëm një kërkesë lidhur me shprehjen e interesit. Zoti Ilir Rusi ka shprehur interesin për t'u zgjedhur në detyrën e Zëvendëskryetarit.

**Fatmira Luli:** Paraqes interesin për të parashtruar kërkesën time për konkurrim për Zëvendëskryetar.

**Naureda Llagami:** Kemi dy shprehje interesi.

Kemi shprehje tjetër?

*(Nuk ka, ndaj fleta e votimit do të përmbajë emrat e dy kandidatëve/anëtarëve: znj. Fatmira Luli dhe z. Ilir Rusi.)*

Rregullat përcaktojnë që votimi është i hapur. Kandidati voton edhe për veten.

#### Procedura e votimit:

Fleta e votimit përmban emrat e dy anëtarëve: znj. Fatmira Luli dhe z. Ilir Rusi.

Fletët e votimit u shpërndahen të gjithë anëtarëve të cilët pas votimit fusin fletët e palosura në kutinë e tejdukshme të votimit.

Më pas nga administrata hapen fletët e votimit, si dhe lexohen votat e secilit anëtar lidhur me zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si më poshtë:

Zonja Brikena Ukperaj ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zonja Irena Plaku ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zoti Klodian Kurushi ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zonja Naureda Llagami ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zonja Fatmira Luli ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zoti Alban Toro ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zonja Yllka Rupa ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zoti Ridvan Hado ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zonja Marçela Shehu ka votuar për zonjën Fatmira Luli.

Zoti Dritan Hallunaj ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Zoti Ilir Rusi ka votuar për zotin Ilir Rusi.

Në përfundim të leximit të votave, rezultoi se zoti Ilir Rusi ka marrë 7 (shtatë) vota dhe zonja Fatmira Luli ka marrë 4 (katër) vota.

*Naureda Llagami:* Atëherë, siç rezultoi edhe nga votimi, fitues është zoti Ilir Rusi me 7 (shtatë) vota dhe në vendin e dytë është zonja Fatmira Luli me 4 (katër) vota.

Në zbatim të ligjit dhe të rregullores zgjidhet zoti Ilir Rusi Zëvendëskryetar i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Kalojmë në votim?

Apo s'kemi nevojë të kalojmë në votim.

E votuam!

Me kaq po e mbyllim edhe mbledhjen e sotshme, duke i uruar suksese kolegëve, dhe zotit Rusi për detyrën.

\* \* \*

(Pika 5 e rendit të ditës)

**Për Këshillin e Lartë Gjyqësor**